

VENDIM
Nr. 820 , datë 26.12.2018

**PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I SHESHIT ‘ITALIA’”,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e fondeve nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018, te Bashkia Tiranë, me vlerë të përgjithshme prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, për ndjekjen e procedurave për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i sheshit ‘Italia’”, Tiranë.

2. Procedura e shpronësimit, për realizimin e projektit, do të ndiqet në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama